



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME,
SIGURI DHE MBIKËQYRJE TË FSK-SË, E MBAJTUR MË 15 DHJETOR 2015**

**DHJETOR
2015**

KRYESUESI(Fadil Demaku): Përshëndetje, besoj që jemi gati të hapim këtë takim.

Siç e dini e kemi dëgjimin publik për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të policisë.

Fillimisht ju përshëndes kolegë deputetë,
Përfaqësuesit e policisë ,
Përfaqësuesit e agjencive të ndryshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nga shoqëria civile,
dhe të gjithë të pranishëm,

Komisioni funksional për Sigurinë në kuadër të fushëveprimit ka edhe atë efektin e mbikëqyrjes, zbatimit të ligjeve nga institucionet që mbikëqyrin.

Komisioni vetë është përcaktuar për të bërë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për policinë, ku komisioni ka formuar edhe grupin punues ku ka punuar vazhdimisht në këtë drejtim dhe tash e kemi në fazën e finalizimit ku kemi paraparë edhe dëgjimin publik.

Unë pa humbur kohë do t'ia jap fjalën kryetarit të grupit punues brenda Komisionit zotit Nuredin Ibishi që ka udhëhequr grupin për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, pasi ta përfundon prezantimin ai pastaj do të jetë radha e të gjithë juve të shprehni qëndrimet e juaja.

Urdhëro, zoti Ibishi!

NUREDIN IBISHI: Faleminderit, zoti zëvendëskryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues,

.

Inspektoratin Policor

zotin Hilmi, institucioni i Avokatit të Popullit, përfaqësues tjerë, mediat,
unë shkurtimisht dua të shpjegoj lidhur me aspektinmbikëqyrjes së zbatimit të ligjit. Së pari autorizimi vjen nga Rregullorja e Kuvendit të Kosovës, neni 71, paragrafi 1 cakton komisionet funksionale, mbikëqyrjen, zbatimin e ligjeve nga fushëveprimi i vet.

Si kryesues i grupit punues ju njoftoj se në kuadër të procesit të mbikëqyrjes së Ligjit për policinë kemi ndërmarrë këto aktivitete.

Së pari dua të ju njoftoj se ne jemi kritikuesi edhe si komision kemi qenë subjektiv në mbikëqyrjen e forcës së sigurisë po në fakt s'jemi kursye ndaj policisë, të jemi pak më kritikë po me qëllim më të mirë të përmirësimit edhe të performancës edhe të përgjegjësisë dhe ngritjen e të detyrave dhe autorizimeve dhe zbatimi i tyre, edhe më që policia vepron me të gjitha institucioneve tjera të zbatimit të ligjit, prokurorinë, gjykatat edhe që ka një rol shumë të veçantë përveç hetimit të kryerjes së veprës penale edhe kundërvajtjeve ka një detyrë të veçantë edhe për parandalimin e tyre.

Pra, ne fillimisht unë po e përshkruaj shkurtimisht që pas këtij dëgjimi të kem edhe raportin e grupit punues.

Pra, pasi që është në format e mbikëqyrjes ku përshkruhet që së pari duhet të bëhet një dëgjim paraprak që ne kemi kryer para fillimit të punës duke i ftuar të gjithë palët e interesit edhe vizitën në terren.

Pra, i kemi bërë dy pyetësorë. I pari ka qenë në 30 pyetje, ku 27 kanë qenë nga një dhe 3 kanë qenë pyetje të komisionit që ka pasur të bëjë nga raporti i progresit, nga analiza e rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë dhe i treti ka qenë lidhur me rekomandimet e Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen Buxhetore që ne nuk i kemi trajtuar në këtë rast edhe më vonë pas pranimit të pyetësorit, dërgohet pyetësorin tjetër me 24 pyetje shtesë, e falënderojmë shumë gjatë gjithë fazës edhe të dëgjimit publik edhe të këmbimit në formë elektronike të pyetësorëve edhe dërgimit me kohë. Ne kemi informacione të duhura.

Po ashtu kemi pasur tryezën në prill të këtij viti në SIRIUS dëgjim publik. Janë vizituar mes tjerash edhe Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Akademia për Siguri Publike, Agjencioni i Forenzikës prokuroria dhe Gjykata Themelore në Prishtinë, Avokati i Popullit, Njësitë Speciale Intervenuese dhe Operative, Drejtoria e Standardeve Profesionale, Flota e Automjeteve të Policisë së Kosovës, Stacioni Policorë i Policisë Kufitar vendkalimi në Merdarë, Shoqata e Gruas Police, Zyra për të Drejtat e Njeriut, Divizioni i Trafikut, Drejtoria Rajonale e Prizrenit në Stacionin Policor, Stacioni Policor Sredskë edhe Stacioni Policor të kalimit kufitar në Vërmicë edhe kjo ishte nga vizitat në terren.

Pra tash unë veç shkurtimisht po përmendi disa të gjetura për të cilën me siguri do të ketë edhe debat, por këto nuk janë përfundimtare për atë edhe e kemi këtë dëgjim publik që t'i qartësojmë.

Në të gjetura është zbatimi jo i plotë i disa dispozitave ligjore, mungesa e zbatimit të procedurave standarde operative në praktikë si dhe metodologjia e punës policore ka mangësi

Mandej, e gjetura tjetër është niveli jo i duhur i bashkëpunimit mes institucioneve përkatëse të zbatimit të ligjit në aspektin edhe të bashkëpunimit të Policisë me qytetarë edhe pse janë ndërtua politika duke filluar prej planit veprimit edhe si metodologjia e punës policimi në komunitet, bashkëpunimi me qytetarë është ende mungesë. Aspektet e bashkëpunimit me prokurorinë edhe gjykatat gjithashtu çalon por e di tash është bërë një doracak i punës edhe çdo herë thirrrem në diçka që nuk është zbatuar dikur e di fort mirë kur ka qenë edhe Ligji për policinë gjyqësore ai fatkeqësisht asnjëherë për shkak të mungesës së vullnetit politik nuk është miratua në të kaluarën 2004, nuk është miratua, tash nuk ekziston edhe prokurorët, edhe gjykatësit, edhe policia thirret në atë që kemi me qenë mirë që të bëhet Ligji për Policinë Gjyqësore me funksionalizuar çështjen e aspektit të bashkëpunimit mes këtyre institucioneve të zbatimit të ligjit në rend të parë të policisë po edhe aspektit edhe të Prokurorisë edhe gjykatave.

Sistemi i përpunimit, analizimit të statistikave si dhe zbatimin e aktiviteteve parandalues edhe të krimit, të kundërvajtjeve nuk është në nivelin e duhur po mendoj në aspektin që po jap një shpjegim. Statistikat i shërbejnë çdo herë aspektit të angazhimit policor sidomos në parandalim, edhe në trafik edhe në parandalimin e kriminalitetit sidomos kur ka trend të rritjes edhe nuk është bërë në mënyrën më të mirë edhe pse ekziston si PK dhe si sistem.

Mungesa e programit edukativo të trajnimeve në të gjitha nivelet e policisë, mësimi dhe të ngritjes së kapaciteteve të vazhdueshme në punë për rëndësinë e parandalimeve përfshirjes së zyrtarëve policor në raste korruptive.

Zbatimi i testit të hetimit të integritetit policor nuk kryhet në masën e duhur nga Inspektorati Policor i Kosovës.

Thuhet këtu që ka pasur diku pesë raste të hetimit të integritetit mirëpo ajo është mbajtur sikur një sekret dhe kemi diskutuar për këtë që ata duhet të jenë të vetëdijshëm edhe zyrtarët policor që ata i nënshtrohen, është edhe autorizim i Inspektoratit Policor ta zbatojë atë në aspektin e hetimit të integritetit. E tash së fundit është bërë projekti i finalizimit me Policinë e Hungarisë edhe ku atje funksionon shumë mirë edhe mendoj që edhe kjo çështje do të zgjidhet.

Pra, kjo mbajtje në brendi të them kështu pa një sistem të njoftimit edhe të strukturës së policisë por edhe të opinionit që ekziston ky sistem i hetimit të testit të integritetit brenda strukturës së Policisë ka krijuar që korrupsioni të jetë prezentë sado në masë të vogël edhe është pakuptueshme që ajo mbetet nën një sistem të një sekreti të brendshëm. Bile në raportin e 2014 nuk figuron asnjë rast i hetimit të testit të integritetit të policisë. Pra, kjo ka qenë më tepër një korrespondim për arsye se kemi pasur aspektet e pakos së standardeve të integritetit javën që shkoi edhe kemi biseduar lidhur me këto detale edhe mendoj që kjo duhet të vijë në rend me qëllim që aspekti i integritetit, ndershmërisë në punë në kundërshtim të policisë të jetë në masën më të lartë.

Marrëdhëniet mes policisë dhe prokurorit publik lidhur me aktivitetet e dyshimta kriminale për të cilën policia u njoftua në pajtim me ligjin, ligjet e aplikueshme nuk janë evidentuar për shkak të mungesës së akteve nënligjore të ligjit për policinë mirëpo po them këtë deri më tash ka munguar një memorandum bashkëpunimi po tash është doracak i bashkëpunimi me polici, prokurori dhe kjo me siguri e tejkalon situatën.

Zbatimi i pjesshëm i nenit 22 të Ligjit për policinë që ka të bëjë me kontrollin parandalues. Është një çështje që këtu bëhet një konfuzion mes kompetencave nga Kodi i procedurës penale neni 74 Kodi i procedurës që ka të bëjë, pyetje kur parashtrahet bëhet konfuzion, kjo është autorizim i pastër policor kontroll parandalues. E dinë edhe z.Riza Shillova ka qenë një prej hartuesve në hartimin e Ligjit të Policisë edhe është thanë që kjo është autorizim, i kemi humbur tri ditë, e dinë fortë mirë kur ka qenë. Mirëpo aspekti i raportimit për përdorimin e këtij autorizimi del jashtë strukturës së policisë domethënë i raportohet prokurorit publik me qëllim që prokurori ta lejoj apo jo atë veprim policor, edhe tash s'po di me referua në atë aspektin sasi se sa është zbatuar kjo, mirëpo çdo herë është bërë konfuzion me aspektet e autorizimit policor në luftimin e kriminalitetit që s'ka të bëjë me atë, ka të bëjë me atë mirëpo është autorizim i brendshëm policor që rrjedh vazhdimisht nga Ligji i Policisë.

Tjetër e gjetur është mungesa e legjislacionit për përcaktimin e infrastrukturës kritike dhe ngarkesa e madhe e policisë në detyra dhe asistencë organeve të tjera ndër tjera roje statike, asistencë e të tjerë.

Kjo në masë të madhe e ngarkon Policinë e Kosovës, Policia nuk mund të merret me punët operative, policia merret me çështje dytësore, kjo gati 1/3 e punës mos më shumë i merr në punë

jo që janë autorizime që rrjedhin nga Ligji i policisë, janë të policisë mirëpo jo në aspektin e punëve operative.

Mungesë tjetër është mos themelimi i policisë rezervë, ne kemi marrë përgjigjen për këtë, ekziston projekti kisha me thanë mos themelime nga aspekti juridik apo de jure është projekti, njoftimin e kemi dërguar me shkrim, mirëpo asnjëherë nuk është funksionalizuar dhe është aspekti buxhetor financiar apo nuk është nevoja për këtë çështje që duhet të trajtohet.

Mandej, mos reformimi i sistemit të gradimit, mungesën 2006-2012 që ka pasur stagnim në avancimet në grada mirëpo, tash fatkeqësisht avancimet janë sipas nevojave të shërbimit të Strukturës Policor, kur ka nevojë atëherë bëhet shpallja e çka di unë edhe nuk ka, vetëm dy grada, polic i ri dhe polic e ka sistemin kohorë të avancimit në karrierë, ndërsa këto të tjera pritet nevoja.

Edhe mendoj që këto është dashtë të bëhet një reformë në gradë e dimë që janë marrë grada edhe në kohën e UNMIK-ut edhe kjo nuk guxon kjo të trashëgohet. E dimë tash që ka me ndodhë aspekti i pensionimit të parakohshëm mirëpo gjithsesi duhet reforma në grada me qëllim që ngritje në karrierë të jetë një çështje e vazhdueshme jo vetëm të nevojës, a ka nevojë për këtë pozitë, madje është shpallja e konkursit e diçka tjetër. Kjo është një çështje që përket shumë në aspektin e ngritjes në karrierë në Policinë e Kosovës.

Mos zbatimit të dispozitave të Ligjit 03/149 për shërbimin civil të Kosovës, të personelit civil të punës në polici. Po ashtu edhe dispozitat e Ligjit të Prokurimit paraqesin pengesa ligjor për punën e policisë të aspektit të punonjësve në polici domethënë kategoritë edhe shërbyes civil apo kategori tjera, zyrtarë në betim, kadetët dhe shërbimi civil, nuk ka autorizime policore, mirëpo këta trajtohen në kuadër të të ligjit, kjo duhet të rregullohet në aspektin e zgjedhjes strukturore me ligj.

Mosha mesatare e zyrtarëve në polici është 43 vjet edhe kjo është shqetësim apo ka të bëjë me policinë më të vjetër në rajon. Mosha e shtyrë ndikon në nivelin e kryerjes së autorizimeve policore dhe kjo është një e gjetur dhe ne e dimë iniciativë më herët për ngritjen apo për hartimin e projektligjit që është veç në Qeveri edhe ajo shpejt do të bëhet ne jemi të interesuar si Komision të ngritnim çështjen edhe në aspektin buxhetor që edhe kjo të miratohet. Mirëpo kemi dëgjuar që aspekti i zbatimit në praktikë për shkak të implikimeve buxhetore, ligji të miratohet vitin e ardhshëm mirëpo aspekti i zbatimit buxhetor do të thotë është në vitin 2017, edhe kjo është një aspekt.

Zbatimi i jo i plotë i rekomandimit të Zyrës së Auditorit që lidhen me pasqyrat financiare vjetore dhe të shpenzimeve buxhetore ato i kemi marrë edhe nuk kisha dashur të diskutoj. Ne kemi bërë draft raportin me të gjitha këto rekomandime por është çështje që duam t'i dëgjojmë të gjitha palët këtu që i referojnë dhe në bazë të asaj çka ne do të marrim impakte do të bëjmë raportin përfundimtar.

Ndoshta kemi qenë kritik, pjesë të shumë të avancuar të policisë tonë që është bërë një ngritje e kapaciteteve, është bërë një polici edhe ne kemi qenë kritik krahas të gjeturave edhe aspekti i mbikëqyrjes është që konsiston për forcimin e Qeverisë demokratike për zbatimin e ligjit edhe

një formë mes neve deputetëve si përfaqësues të popullit dhe përgjegjësi ndaj qytetarëve për shërbim policor.

Mandej, është edhe ngritja e besimit ndaj policisë që është shumë një çështje e rëndësishme përmes kësaj mbikëqyrje, dihet çka bënë policia çfarë shërbimi ofron, gjithashtu është edhe garantimi i konformitetit me standardet ndërkombëtare po vendore dhe ligjore e të tjera, krahas aspektit të drejtave të njeriut por edhe aspekti të parimeve udhëzuese të punës të policisë ku ka të bëjë me trajtimin e drejtë të barabartë të personave, paanshmërisë, integritetit edhe është përgjithësisht në referencën e punës, përmirësimi i shërbimeve policore.

Pra, po e përfundoj dhe po ja kaloj fjalën kryesuesit.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Ibishi.
Urdhëro, Ganimete!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar të pranishëm,

Ju përshëndes të gjithëve,

Duke mbështetur të gjitha ato çka i tha kolegu që kemi qenë në shumicën e takimeve bashkë. Unë desha veç edhe një detaj shumë të vogël të shtoj çka kemi hasur gjatë punës në terren.

Unë kam vërejtur te barazia gjinore nuk është në nivelin e kënaqshëm, do të thotë për shembull ku do që kemi shkua në çdo takim që kemi qenë jemi pritur nga meshkuj, nuk kam asgjë kundër. Mirëpo unë nuk kam pa asnjë përfaqësuese femër, dhe në këtë rast konsideroj që është defekt i madh pikërisht tek gradimi dhe më vjen mirë që kolegu veç e potencoi që duhet të bëhet një reformë në gradim. Do të thotë në Prizren kur kemi qenë për shembull nga 189 policë në bazë të statistikave po flas sepse nuk kam parë femra në përjashtim në parking, thjeshtë nuk dëshiroj që femrat në Policinë e Kosovës të jenë këto që japin dhe mbyllin dyert të parkingjeve sepse konsideroj që në Kosovë ka femra të cilët punojnë në Policinë e Kosovës dhe meritojnë gjithmonë flas mbi bazën e meritokracisë të kenë edhe pozita tjera kyçe në Policinë e Kosovës.

Dhe duke mendua pozitivisht që të kemi me të vërtetë një polici efikase dhe të reformuar mendoj që duhet të ju krijohet një hapësirë më e madhe gjinisë femërore dhe të mos i lëmë të punojnë në parkingje të policisë ose thjeshtë në hapjen dhe mbylljen e dyerve kur të vijnë delegacioni.

Do të thotë nga 189 policë sa ka gjithsej personeli i policisë në Prizren, kemi vetëm 20 femra, nga këto 20 arri të shoh dy në parking do të thotë për mua ishte ofenduese si deputete e gjinisë femërore në këtë rast sepse konsideroj se ka kualitet dhe ka mundësi të cilat gjithashtu kemi hasur të gjetura edhe në zbatueshmërinë e ligjit kur ka të bëjë me pushimin e lehonisë te policet.

Prandaj, konsideroj që edhe sot me që jemi në përbërje të tillë unë do të marrë disa imputo edhe nga të pranishmit këtu dhe tash duhet të bëjmë atë që është më e mirë e mundshme në raportin kur do t'ia paraqesim edhe Kuvendit dhe nëse ka nevojë për plotësim ndryshimin të Ligjit.

I kisha përmend edhe dy ankesa ndoshta një konkretisht unë e kam pa dhe qe kam pa shumë reale dhe më shumë shqetësuese faktikisht. Për shembull ndërrimi i natës i policisë paguhet 5

euro. Konsideroj që kjo duhet të ndreqet me ligj, përderisa një infermiere paguhet 18 euro, nuk kam kundër, uroj që infermierja të paguhet edhe 30 euro, 50 euro nëse ne kemi mundësi por konsideroj që nuk është e drejtë që një polic duke pasur parasysh rrezikshmërinë që e ka paguhet 5 euro në ndërrimin e natës.

Dhe gjithashtu me që sot jemi në mesin e dhjetorit po shpresoj shumë me rishikimin e buxhetit në qershor ose thjeshtë të jemi të përgatitur ndoshta edhe për buxhetin e vitit tjetër, kish me qenë mirë që të paramendohet që në Komision të kërkohet që Policia e Republikës së Kosovës ta marrë edhe rrogën e 13, duke marrë parasysh angazhimin e madh që ka. Ne jemi dëshmitarë të gjendjes aktuale në Kosovë dhe sinqerisht janë për dhimbje policët të cilët shërbejnë deri në orët e vona të mesnatës në Parlamentin e Republikës së Kosovës dhe në mënyrën me pa dinjitet më të mundshme.

Për fillim kaq, por unë do të kyçem edhe në vazhdim gjatë debatit. Vetëm këtu te barazia gjinore nuk munda me e lënë me na rrëshqit sepse unë personalisht jam tepër e shqetësuar gjatë punës në terren. Faleminderit!

KRYESUESI: Natyrisht që i përkrahi këto çka i tha Ganimetja, mundet me na thanë dikush femrat JANË përkrahur Policinë e Kosovës, presidentja nga Policia e Kosovës në përgjithësi unë i përkrahi të gjitha çështjet që i ngrite edhe Ganimetja. Nur, pate diçka me shtua apo...

NUREDIN IBISHI: Desha diçka të shtoj që është aspekti që edhe ne rekomandime do e kemi edhe atë edhe bënë pyetje që janë parashtrua edhe nga aspekti gjinore është 14.34% kemi marrë përgjigje edhe interesi që kjo mos të jetë vetëm në aspektin numerik por kualitativ dhe duhet me marrë parasysh nga pozitat menaxheriale.

GANIMETE MUSLIU: Kërkoj falje se u bë një bashkëbisedim mes neve treve kështu që, unë e them këtë jo me plotësua standardin gjinorë edhe të jetë estetikisht bukur një format në Policinë e Kosovës. Këtë e them nga përvoja të cilën e kam pasur gjatë këtij viti, unë gjatë gjithë vitit kam pasur një bashkëpunim të jashtëzakonshëm me shoqatën e grave police për çka dua të falënderoj publikisht edhe presidentet e Shoqatës zonjën Taibe Canolli e cila sot është me neve dhe kam pa që ka kualitet.

Unë kam vizitua dy stacione të policisë që udhëhiqen nga gratë njëra që është në Fushë Kosovë dhe Stacioni regjional që është në Gjilan dhe me të vërtetë unë jam befasua pozitivisht me punën që e bëjnë ato dy femra në udhëheqjen e këtyre stacioneve dhe janë shembulli më i mirë se si një femër mund të udhëheq një dikaster i cili është në kuadër të Policisë së Kosovës.

Duke marrë parasysh problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen sepse unë e kam ngritë edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës ku kushtet e punës në Gjilan janë tmerrësisht të këqija.

Unë edhe sot nuk e di pse Stacioni Policor ose ndërtesa e Stacionit Policor në Gjilan ende është e papërfunduar kur ka fillua para 6-7 viteve.

Në ato kushte një femër mund të menaxhoj në mënyrë të mrekullueshme punën për çka është e ngarkuar, kur ato të dyja mujnë pse të mos mujnë edhe femrat tjera që unë kam pa kualitet të

mjaftueshëm. Prandaj, unë nuk jam ithtarë, kolegët e mijë e dinë që nuk jam ithtar veç me qenë një femër prezentë, por te jenë femra të merituar dhe unë mendoj që në Policinë e Kosovës ka femra që meritojnë të jenë në pozita kyçe sepse e përsërisë nuk jam ndier mirë kudo që kemi shkua në terren e vetmja femër në Komision asnjë femër nuk na ka pritë askund në delegacionin ku kemi marrë pjesë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ja kalojmë fjalën përfaqësuesit të Policisë së Kosovës.

RIZA SHILLOVA- Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar të pranishëm,

Përshëndetje për të gjithë,

U diskutua dhe u prezantuan shumë çështje që nuk e di sa do të kem mundësi ti përmbledh të gjitha.

Unë do ta marrë pjesën e parë të prezantimit dhe të diskutimit dhe dhënies së komenteve por edhe përgjigjet në ato çështje që u diskutua, më pas duke u lënë hapësirën edhe kolegëve tjerë që vijnë nga Policia e Kosovës dhe institucione tjera me punën e përbashkët. Por unë dua të ju falënderoj për mundësinë që na e keni dhënë që të jemi këtu. Ne në vazhdimësi kemi qenë aktiv në përgjigjëjet dhe në takimet që i kemi pasur lidhur me zbatimin Ligjit të Policisë, sikur që ne kemi nevojë ti mirëpresim kritikën dhe sugjerimet, këshillat ne kemi nevojë edhe për përkrahje dhe mbështetje.

Vizioni ynë është që të kemi një polici profesionale dhe efektive në zbatimin e ligjit në Kosovë dhe Ligji i Policisë e ofron këtë mundësi, ku kam pasur fatin të jem edhe pjesë e hartimit të ligjittë Policisë bashkë me juve dhe mendoj që dispozitat që i paraqet Ligji i policisë janë mundësi jashtëzakonisht e mirë e jona që t'i realizojmë me sukses detyrat në teren edhe kjo me thënë të drejtën është opinion i jonë që i ka mbijetuar njëfarë mënyre edhe kësaj kohe prej kur është hartuar deri sot kjo tregon edhe për kualitetin që ka Ligji i policisë në procesin e hartimit.

Ligji në përgjithësi po flas është më i përgjithshëm dhe jep dispozita të përgjithshme për veprimtarinë policore për çështje të organizimit, për menaxhmentin, për standardet etj., etj., dhe më detajisht mandej është rregulluar me akte nënligjore, të cilat do t'i preki fillimisht tu u ndërlidh me disa nga çështjet të cilat u debatuan këtu.

Nga ligji kanë dal disa udhëzime administrative që besoj ju i keni parë dhe keni raportin, të cilat janë duke u implementuar, por paralelisht me udhëzimet administrative janë hartuar edhe procedura standarde të operimit dhe procedurat standarde të operimit janë të shumta sepse secila drejtori ose secila njësi organizative në kuadër të Policisë së Kosovës harton procedura standarde të mënyrës së zbatimit ose të kryerjes së veprimtarisë policore në kuadër të njësisë ose sektorit, të cilit i takon.

Në kuadër të ligjit dalin ose nga ligji burojnë edhe strategji ose metodologji të reja të punës, u përmend këtu metodologjia e cila është duke u zbatuar në polici që ka të bëjë me policimin në komunitet, por edhe policia e udhëhequr nga intelijenca që ndërlidhen mes vete. Ne kemi filluar këtë proces bukur kohë të gjatë, normalisht ne e kemi dit që edhe në momentin kur kemi filluar këtë proces kjo do të jetë një rrugë jo e shkurtë, por e gjatë dhe ne synojmë që vazhdimisht bashkëpunimin e komunitetit ta kemi si prioritet tonin jo vetëm për parandalim edhe në fushën e

rendit të sigurisë publike, por edhe në fushën e luftimit edhe të kriminalitetit ose të veprave penale më të rënda përfshirë këtu krimin e organizuar, korrupsionin, por edhe terrorizimin, sepse ne e dimë që pikërisht kjo strategji jep rezultate dhe ka dhënë rezultate edhe në shtetet tjera dhe si metodologji është pranuar edhe nga ne.

Ju besoj e keni parë në raport ne kemi prezantuar edhe themelimin e trupave për bashkëpunim me komunitet që janë këshillat komunale për siguri publike dhe komitetet lokale për siguri publike, që gjithsej janë 34 këshilla komunale për siguri publike dhe 52 komunitete lokale për siguri publike, të cilat e kryejnë aktivitetin e vetë dhe që policia jep një kontribut jashtëzakonshëm.

Komitetet lokale për siguri publike janë themeluar me vendim të drejtorit në ato lokalitete ku kemi konsideruar që është e domosdoshme dhe e nevojshme që ne ta rrisim bashkëpunimin me qytetarë në mënyrë që komunitetin ta kemi partnerë në punën tonë. Ne e dimë që ka akoma dhe kjo punë nuk përfundon, unë mendoj që edhe policitë më bashkëkohore, më moderne të shteteve edhe më të zhvilluara se Kosova akoma punojnë vazhdimisht edhe reformohen në këtë kontekst.

Ne e pranojmë konceptin e reformimit të vazhdueshëm edhe vazhdimisht përpiqemi edhe konceptin e trajnimit të edukimit, të zhvillimit të policisë e kemi të ndërtuar mbi bazën e reformave të vazhdueshme të Policisë së Kosovës edhe ligji besoj që e jep këtë mundësi, sepse ka dispozita të përgjithshme që na lejon neve hapësirën dhe mundësinë që vazhdimisht të bëjmë reforma. U përmend bashkëpunimi me Prokurorinë, Gjykatën, realisht është ajo që u prezantua edhe nga kryetari i komisionit ose i grupit për mbikëqyrje të zbatimit të Ligjit të policisë që ne në projektin e binjakëzimit që kemi tani që është nga Komisioni Evropian që ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit, kemi hartuar një manual të përbashkët lidhur me procedurat mes Policisë dhe Prokurorisë.

Ky manual neve do të na ndihmojë që në të ardhmen t'i harmonizojmë më mirë procedurat sa i përket çështjeve të nivelit strategjik, menaxherial, takimeve të përbashkëta, pastaj formularëve të përbashkët, mënyrës së ushtrimit të veprimtarisë, koordinimit të aktiviteteve polici, prokurori.

Ky manual veç është i gatshëm, është i përkthyer domethënë edhe në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës dhe ky do të na shërbej neve për të ardhmen që ta ngrisim akoma bashkëpunimin me prokurorinë.

Bashkëpunimi me prokurori shtrihet në të gjitha nivelet prej nivelit qendror, nivelin rajonal, por edhe në nivelin lokal edhe stacionet policore. Ne nuk kemi ankesa, dhe nuk kemi shqetësime serioze sa i përket bashkëpunimit polici-prokurori, ky bashkëpunim mendoj që është i sigurtë dhe mendoj që është në frymën e zbatimit të ligjit. Ne në disa prokurori ndajmë edhe objektet e përbashkëta, pikërisht fjalën e kam këtu për prokurorinë speciale, departamenti i hetimeve një pjesë e strukturës së tij është bashkarish në të njëjtin objekt me prokurorinë speciale dhe kjo e mundëson pak a shumë edhe bashkëpunimin që të jetë më cilësor dhe më i përafërt.

Sa i përket u përmend pak policia gjyqësore, ne e dimë që kodi i kaluar i procedurës penale ka paraparë ose ka pas në dispozitat e tij paraparë themelimin e policisë gjyqësore e cila është vlerësuar me kohë dhe nuk është funksionalizuar dhe me hartimin e kodit të ri të procedurës penale, policia gjyqësore domethënë është heq si koncept ose si strukturë nga vlerësimet që janë

bërë në atë kohë në procesin e hartimit të kodit të procedurës penale është parë që nuk është e arsyeshme themelimi i policisë gjyqësore, sepse kompetencat e policisë gjyqësore në fakt janë kompetenca të cilat i kanë të gjithë zyrtarët policor e sidomos zyrtarë policor të cilët punojnë në hetimet e krimit.

Sa i përket sistemit të përpunimit statistikor ose të dhënave, ne e kemi parë këtë si defekt nga analizat dhe vlerësimet që i kemi bërë në vitet e kaluara dhe si rezultat i kësaj ka ardhur edhe deri te ndërtimi i një sistemi të ri të të dhënave u përmend pak më herët, sistemi informativ i policisë së Kosovës ose i njohur ndryshe me emrin “SIP” i cili ka filluar të zbatohet këtë vit. Domethënë, është një sistem i madh i cili shtrihet në të gjitha njësitë policore, është sistem i cili ka qenë gjithashtu donacion i Komisionit Evropian, sistem me standardet më të larta.

Ne kemi bërë edhe vlerësimet tona sa i përket këtij sistemi edhe jemi në proces të vlerësimit të zbatimit praktik të brendshëm të këtij sistemi. Kemi hartuar edhe një program, respektivisht kemi ndërtuar një bazë të dhënave ose një softuer të veçantë i cili na mundëson vlerësimin drejtpërdrejtë elektronik të zbatimit të këtij sistemi në praktikë. Normalisht që ne e dimë që për shkak të kompleksitetit që ka ky sistem do të merr kohë në zbatimin e plotë, por megjithatë mendoj që jemi në rrugë të mirë që ne ta përmirësojmë akoma më shumë çështjen e statistikave sa i përket fushës së policisë.

Ne në këtë vazhde kemi bërë edhe një studim të interoperabilitetit të databazave të institucioneve të zbatimit të ligjit, sepse për të qenë policia efikase duhet të ketë ndërlidhje edhe me agjencitë ose institucionet tjera. Në kuadër të studimit të interoperabilitetit ne kemi bërë analizën dhe vlerësimin e 25 bazave të të dhënave të institucioneve të zbatimit të ligjit përfshirë edhe disa agjenci në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me të cilat policia ka nevojë të ketë një ndërlidhje të bazave të të dhënave ose shkëmbim të informacioneve në mënyrë të drejtpërdrejtë. Këtu hynë edhe prokuroria dhe sistemi gjyqësor.

Shumë agjenci kanë të ndërtuar baza të të dhënave por ne akoma nuk e kemi një sistem të bazave të dhënave elektronike në prokurori dhe gjykatë, i cili është një deficit edhe për neve sepse shkëmbimi i të dhënave në kohë reale me këto agjenci është i pamundur. Ne përpos këtij studimi ku kanë dal edhe rekomandimet konkrete, ne kemi bërë edhe shkëmbimin e zyrtarëve ndërlidhës që do të na ndihmojnë neve që në kohë reale t'i shkëmbejmë të dhënat sidomos me njësinë e inteligjencës financiare dhe me Doganën e Kosovës.

Kemi nënshkruar gjithashtu këtë vit në fund të këtij viti është nënshkruar edhe një marrëveshje mes agjencive të zbatimit të Ligjit për themelimin e komisionit në fushën e teknologjisë informative. Ky komitet më falni mes agjencive të zbatimit të ligjit ka për qëllim që t'i ndërtojë ose t'i themelojë standardet në fushën e infrastrukturës, respektivisht në fushën e teknologjisë informative sa i përket politikave, çështjeve të personelit, buxhetit standardeve etj., etj.

Po e them këtë me një arsytim se ne kemi sisteme të bazave të dhënave që janë dhënë edhe donacion, por edhe që janë ndërtuar nga institucionet në veçanti dhe kjo nganjëherë neve na shkakton probleme dhe të ndërlidhjes mes tyre ose të komunikimit mes tyre dhe kjo tani do ta mundësojë, ky koordinim mes agjencive do ta mundësojë në të ardhmen që ne të kemi sisteme ose të ndërtojmë platforma të cilat na mundësojnë neve komunikimin e ndërsjellët.

Mendoj që kjo është ajo që është vizion i Policisë së Kosovës për ta ndërtuar dhe për ta ditur se nga jemi duke shkuar dhe për ta ndërtuar infrastrukturën e cila më vonë do të shfrytëzohet ose do të përdoret prej zyrtarëve zbatues. U fol për testin e integritetit besoj që kolegët nga Inspektorati Policor do të përgjigjen më detajisht ka qenë edhe konferenca të cilën e përmendët ju. Unë vetëm kisha përmend një argument shtesë sa i përket testit të integritetit normalisht besoj edhe për opinionin edhe për juve është e njohur që Policia e Kosovës ka një kredibilitet në opinionin publik edhe kjo për neve është mirë.

Ne vazhdimisht përpiqemi ta rrisim përkrahjen sepse konsiderojmë që komuniteti është ajo që neve na jep mundësinë më të madhe për t'i realizuar detyrat tona. Në këtë drejtim ne kemi ra dakord bashkë me mbështetjen e Komisionit Evropian përmes një projekti që ta ndërtojmë një sistem parandalues, një sistem të paralajmërimit të hershëm sa i përket integritetit policor edhe ky sistem nënkupton që të kemi zyrtarë të caktuar, të veçantë, të cilët do të hulumtojnë dukuritë të cilat mund të shprien në çështje ose në dukuri korruptive më vonë dhe me qëllim që të këshillohet drejtori i përgjithshëm ose stafi i lartë i Policisë së Kosovës që të marr masa parandaluese me kohë, të krijojë politika, të hartojë standarde të cilat e ndihmojnë integritetin policor e jo vetëm të merremi me çështje reaktive.

Për pjesën tjetër besoj të zbatimit të Ligjit IPK sepse kryesisht Ligji i PK-së e parasheh testin e integritetit dhe unë besoj që do të flasim kolegët nga Inspektorati Policor të cilët janë këtu sot. Sa i përket zbatimit të Ligjit të policisë nenit 22 që përmend kontrolli parandalues unë jam dakord që ky është një autorizim policor i paraparë me Ligjin e policisë që nuk ndërlidhet me Kodin e procedurës penale me përjashtim të rasteve kur kërkohet që të raportohet te prokurori mandej që të respektohen ato procedura që parasheh edhe Kodi i procedurës penale.

Në fakt, është një autorizim jashtëzakonisht i madh për policinë dhe është një autorizim që policia duhet të ketë kujdes edhe në zbatim të këtij dhe kjo ka shty policinë që të mos e zbatojë, jo të mos e zbatojë por të mos ketë raste të shumta në praktikë ku do të zbatohet ky nen.

Janë këto kryesisht kontrollet të cilat kryhen në rastet e parandalimit të terrorizimit ose të parandalimit të veprave të rënda penale të cilat besoj që i ndërmerr çdo polici. Ne jemi koshient ose jemi të vetëdijshëm për procesin ose për mënyrën edhe për përmbajtjen e këtij neni edhe sa herë që ka mundësi kjo edhe do të zbatohet në praktikë, por është një autorizim jashtëzakonisht i ndjeshëm i cili mund të atakojë në njëfarë mënyre mund të jetë ndoshta neni më i ndjeshëm sa i përket edhe raportit të respektimit, të lirive edhe të të drejtave të njeriut edhe kjo është njëra ndër çështjet që ne kemi parasysh çdo herë në zbatimin e këtij neni edhe prandaj ky nen është zbatuar më pak. Por, unë nuk shoh kurrëgjë të keqe që ky autorizim është në Ligjin e policisë dhe sa herë që ka mundësi edhe që ka nevojë ne e përdorim këtë në praktikë.

U përmend infrastruktura kritike, është e njohur besoj edhe për ju edhe për të gjithë që neve na mungon një ligj i veçantë i cili përcakton çështjet që kanë të bëjnë me infrastrukturën kritike me sa kam informacion ndoshta mundet të na ndihmojnë edhe kolegët nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ky ligj veç është proceduar në kuadër të strukturave të veçanta të Qeverisë për hartim, e di që është diskutuar edhe në kuadër të strategjisë që kemi pasur për sigurinë kibernetike, sepse kjo ndërlidhet edhe me infrastrukturën kritike, prandaj besoj që ky ligj do të

vjen edhe në Kuvend shpejt edhe do të procedohet, dhe mendoj që për neve është shumë e rëndësishme të përcaktohet infrastruktura kritike ose të përcaktohet baza ligjore e infrastrukturës kritike mandej ne të kemi mundësinë edhe në aspektin operacional të ndërmarrim masa për sigurinë ose për mbrojtjen e infrastrukturës kritike.

U përmend edhe asistenca, ato se detyrat policore të cilat kryhen e që nuk janë ndoshta tipike policore në disa raste, besoj që ju e keni parë edhe raportin ne kryejmë shumë detyra dhe aktivitete ose asistime institucioneve ose agjencioneve tjera janë diku 6 mijë e 339 asistenca ose mbështetje që ju kemi bërë vitin e kaluar institucioneve tjera. Këtu hyjnë gjykatat më së shumti me 2 mijë e 745 asistime, pastaj kuvendet komunale me 2 mijë e 176, e kështu me radhë.

Ne e dimë që Policia duhet të lirohet nga disa nga këto asistime, por duke parë parasysh edhe nevojën që kanë institucionet tjera për tu mbështet nga policia ne vazhdimisht përpiqemi që të jemi në ndihmë dhe përkrahje të tyre dhe vazhdimisht jemi në kontakt dhe në diskutime me ta që ata të ndërtojnë mekanizma të brendshëm në mënyrë që t'i marrin këto detyra dhe përgjegjësi dhe në mënyrë që policia të lirohet dhe të ketë mundësi të merret me punët që i quajmë tipike policore.

Kjo është një synim që vazhdimisht por nuk është e lehtë kjo të ndërrohet, sepse ne konsiderojmë se nëse bëjmë një ndryshim drastik këtu si polici në mënyrë vetanake mund ta dëmtojmë punën e disa institucione që janë gjithashtu mendoj kritike për shtetin. Themelimi i Policisë rezervë, është një temë u tha mirë që është ndërtuar koncepti është ndërtuar sistemi ashtu siç kërkohet edhe në bazë ligjore dhe problemi kryesor i mos themelimit të policisë rezervë është buxheti. Domethënë, nëse ne kemi buxhet i cili do të alokohet për këtë çështje ne nuk kemi problem për ta themeluar edhe policinë gjyqësore, normalisht ne kemi nevoja praktike për mbështetjen e disa situatave ku do të kishim pasur mundësi me angazhuar, por kjo është një çështje që nuk varet krejt prej neve unë besoj që këtu do ta kemi edhe mbështetjen e komisionit.

U përmend te sistemi i gradimit, është reformuar do të thotë në vitin nëse nuk gaboju 2012, diku nga po i plotësuar në 2013 prapë, diku 2006-2012 ne nuk kemi pas proces të gradimit fare në Policinë e Kosovës dhe kjo ka ndikuar që një kohë të stagnojmë me këtë proces dhe mos të kemi edhe motivim për zyrtarët policor, por që nga viti 2012 është zgjedh ky problem dhe është duke vazhduar ajo që unë besoj që tani neve na duhet edhe ndihma edhe përkrahja juaj është që të ec Ligji për pensionimin e parakohshëm sepse pikërisht ekzistimi i shumë gradave në polici në disa pozicione e pamundëson procesin e gradimit për gjeneratat e reja. Dhe kjo mendoj që jo vetëm të gradimit, por u përmend edhe më herët edhe mosha mesatare, normalisht ne jemi shqetësuar dhe prandaj ne kemi bërë edhe propozimin për hartimin e ligjit të ri për pensionim të parakohshëm, duke e pasur parasysh edhe nevojat që i kemi në praktikë ne në zbatimin e ligjit.

Kjo është një domosdoshmëri, besoj nuk ka nevojë arsyetim pra ndërlidhet edhe me procesin e gradimit, sepse krijon mundësi dhe hapësirë për gjeneratat e reja dhe për promovim dhe për kualitet më të mirë, sepse e dimë mirëfillin prej momentit kur është themeluar Policia e Kosovës deri sot, edhe procesi i trajnimit, edhe procesi i zhvillimit në karrierë ka evoluar jashtëzakonisht shumë dhe sot jemi me një staf krejt tjetër të ndërtimit të kapaciteteve ose të trajnimit të zyrtarëve policor ose të zhvillimit të tyre duke filluar nga arsimi ose trajnimi teorik ashtu edhe ai praktik, prandaj kjo mundëson që vazhdimisht ne gjeneratat e reja të kemi kualitet më të lartë

dhe për këtë jemi të vetëdijshëm dhe kjo shihet besoj që edhe në rrugët e Prishtinës gjeneratat e reja të cilët janë të rekrutuar.

Prandaj, kjo është që mendoj që është një çështje që i kalon pak suazat edhe të policisë, ku kërkohet ose ne kërkohet edhe mbështetjen edhe nga Qeveria, por edhe nga Kuvendi sepse është një çështje që duhet të ndërlidhet edhe me Ligjin e thash për pensionim.

Sa i përket zbatimit të Ligjit të shërbimit civil kjo është një çështje besoj për neve e qartë ne e kemi Ligjin ose nenin 44 të Ligjit të policisë i cili e përcakton kategoritë ose i përcakton kategoritë e të punësuarve në Policinë e Kosovës ku parashihen tri kategori: zyrtarë policor, stafi civil dhe kadetët policor. Ndërsa, paragrafi 2 i këtij neni e përcakton që marrëdhënia e punës më detajisht rregullohet me akt nënligjor për të gjitha tri kategoritë e personelit policor.

Sa i përket procedurës disiplinore, gjithashtu janë nenet e veçanta përfshirë edhe Ligjin për inspektoratet policore që përcakton procesin disiplinor për stafin ose për personelin policor përfshirë edhe stafin civil dhe çfarëdo ndarje tani mes stafit civil dhe zyrtarëve policor paraqet një rrezikshmëri për sistemin unik të Policisë së Kosovës dhe për sistemin e shkallshmërisë në kuadër të policisë.

Ne i kemi ndërtuar mekanizmat edhe disiplinës, por edhe të menaxhimit të personelit në polici që ndoshta nuk ka nevojë të hyjmë në detaje që mendoj që është jashtëzakonisht efikas, kjo ndikon edhe në pavarësinë e policisë sepse realisht me ligj drejtori i policisë e ka autoritetin të menaxhojë me policinë në aspektin operacional dhe menaxhimin e buxhetit, menaxhimin e personelit, menaxhimin i çështjeve tjera mbështetëse është një mbështetje për pavarësinë e policisë që ne konsiderojmë që policia në këtë aspekt duhet ta gëzojë at autorizim që ka me ligj siç e theksova në nenin 44.

U fol për barazinë gjinore besoj që Kolonelja Taibja është këtu, do të flas më gjerësisht edhe i njeh problemet në vazhdimisht e kemi synim integrimin e femrave në polici sikundër që përpiqemi që edhe grupet tjera etnike të kenë përfaqësim të barabartë ose aq sa është e domosdoshme në polici. U përmend shifra 14.34% e fermave police ne jemi dakord dhe besojmë që duhet të mbështetemi në kualitetin e fermave që kemi police dhe ndaj mendimin që kemi jashtëzakonisht ferma të afta ose profesionale, të cilat kanë dhënë kontribut në të kaluarën edhe që japin kontribut edhe sot. Ka shumë ferma në shumë pozita në kuadër të Policisë së Kosovës, përfshirë drejtorët rajonal, përfshirë komandant të stacionit e thatë ju, kemi drejtorë të divizionit, kemi drejtorë në drejtori dhe në departamentin e hetimeve për shembull ku unë punoj kemi ferma, por ne vazhdimisht duhet të bëjmë përpjekje që të integrojmë dhe ky është një synim edhe është politikë e jona dhe nuk besoj që është qëndrim edhe i stafit të lartë të policisë edhe është politikë e jona e brendshme që vazhdimisht përpiqemi që ta integrojmë ose ta respektojmë barazinë gjinore në kuadër të Policisë së Kosovës.

Unë e di që ka projekte edhe ka ide edhe kemi diskutuar edhe kohëve të fundit se çka duhet të bëjmë më tepër në mënyrë që të kemi një integrim ose të kemi një përfshirje më të madhe të femrës në polici. Unë veç mund ta them një fakt që nga themelimi e deri sot Policia e ka pas përafërsisht 15% femra në polici e që ne nuk jemi të kënaqur, ne kemi një rënie tani të vogël por megjithatë është një rënie që kohëve të fundit janë dhënë rekomandime dhe është hartuar nëse

nuk gaboj kolegia mundet me na ndihmuar më shumë strategjia e burimeve njerëzore ku është një objektiv i veçantë i paraparë për ngritjen e numrit të femrave police në Policinë e Kosovës edhe besoj që kjo do të jep rezultat, por do të jep rezultat vitin e ardhshëm ndoshta edhe vitet e tjera.

Unë kisha përfunduar këtu edhe duhet me ia lënë hapësirën nëse dikush nga kolegët kam harruar ose diçka tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit, i nderuar! Nëse ishit pajtuar më herët ka kërkuar një ndërhyrje me pas avokati i popullit, mbasi mu dok që ishin çështje të cilat kanë referencë me punën që e bëni ju pastaj të tjerët.

Nur, më fal një sekondë. Pa dashur sepse në radhë të parë ju duhet ta kuptoni që pozita e deputetëve është që jemi në mbledhje dhe mund ta marrim fjalën, por për ta ruajtur një baraspeshë të palëve Nur e kam, sepse mund të na krijohet ky takim si dialogim individual i individëve pavarësisht se të gjithë këtu jemi me peshë institucionale çdo njëri që është këtu, në këtë kuptim e kisha fjalën që të mbajmë një baraspeshë të palëve, të ruhen çështjet të cilat janë për diskutim se mund të na krijohet një interferencë.

Urdhëro!

NUREDIN IBISHI- Policia çdoherë për shkak edhe të gjithë kërcënimeve transnacionale po i quajmë s'vepron vetëm brenda strukturave shtetit edhe interes të qytetarëve, por bashkëpunon me vendet edhe që kufizohet edhe rajonale, edhe ndërkombëtare.

Aspekti i bashkëpunimit edhe të integritetit të organizatave ndërkombëtare policore edhe organizatave tjera të sigurisë rajonale shumë shkurtimisht vetëm për atë edhe pse është një e gjetur aty për arsye se për herë të parë po konfirmohet se për herë të parë është aplikuar në Interpol edhe disa herë është thënë edhe nga ministria e mëhershme që është aplikuar, është aplikuar edhe s'janë pranuar. A mundeni veç shkurtimisht.

RIZA SHILLOVA-Tani bashkëpunimi ndërkombëtar vërtetë është një synim edhe objektiv edhe është i pamundur për neve që të realizojmë me efikasitet detyrat tona sidomos në fushën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit pa një bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar. Ne e thatë edhe ju kemi aplikuar sivjet kemi përgatitur aplikacionin, në fakt është bërë shumë punë paraprake në ndërtimin e kapaciteteve në mënyrë që t'i plotësojmë standardet dhe t'i bëjmë disa vlerësime në mënyrë që aplikacioni të jetë i plotë, përpos Interpolit synim i joni është edhe bashkëpunimi me europolin.

Ne kemi një formë të bashkëpunimit me Interpolin edhe sot por që shkon përmes policisë së UNMIK-ut, ndërsa me Europolin gjithashtu kemi një bashkëpunim e që është synim i joni në të ardhmen që ta ngrisim bashkëpunimin në formë edhe formal.

Ne kemi gjithashtu, një sistem që është aktual i bashkëpunimit me Europolin e që shkon përmes EULEX-it, ose DESK-ut suedez, siç njihet te ne. Po, në aspektin operacional me këto dy agjenci dhe institucione, punojnë jashtëzakonisht shumë. Ne kemi edhe hetime të përbashkëta, kemi edhe operacione të përbashkëta, kemi marrë pjesë edhe në takime për çështje të hetimeve dhe operacione edhe në selinë e Europol-it dhe kemi menaxhuar operacione edhe prej atje.

Ne i shfrytëzojmë, sidomos për shkak të kësaj mungese, marrëveshjet bilaterale që i kemi me vendet tjera. deri tash, mund t'u them që në fushën e Policisë në përgjithësi janë 55 marrëveshje ndërkombëtare e që përfshihen marrëveshjet në fushën e kufirit, marrëveshjet në fushën e rendit të sigurisë publike dhe marrëveshjet, që kanë të bëjnë kryesisht me luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve tjera të rënda.

Përpos kësaj, ne shfrytëzojmë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkombëtar, që janë në fushën e doganave dhe të inteligjencës financiare, sepse këto janë çështje që ndërlidhen, sidomos kur kemi të bëjmë me shkëmbim të informatave.

Unë mendoj, që ne kemi dëshmuar kohëve të fundit se jemi partnerë seriozë rajonal dhe ndërkombëtar dhe kjo ka qenë si rezultat i iniciativës vetanake, që kemi pasur për t'u kyçur në operacionet ndërkombëtare ose në hetime ndërkombëtare. Ju e keni parë edhe rastin e fundit, për shembull, në fushën kundër terrorizmit në bashkëpunim me Policinë e Italisë, ku kemi pasur zyrtarë policorë në qendrën operationale në Itali, prej nga është menaxhuar incidenti, pastaj me EUROPOL-in në fushën e migrimin, ose kontrabandimit me emigrantë, në fushën e trafikimit me narkotikë, e tjerë, e tjerë...

Për të mos ju lodhur shumë me këto, normalisht ne kemi vështirësi në integrimin në strukturat ndërkombëtare, por kjo nuk po varet shumë prej nesh, sepse është më shumë edhe vullneti i atyre agjencive ose institucioneve, nganjëherë është edhe çështje politike integrimi ose anëtarësimi në këto organizata.

KRYESUESI: Faleminderit! Do ta bëj një sqarim para se të vazhdojmë

Duke pasur parasysh që tema është jashtëzakonisht e rëndësishme, është temë e cila zgjon diskutim të madh, po dua që këtë takim, këtë mbledhje ta orientojmë në fazën. Do të kërkoja mirëkuptimin e kolegëve deputetë që të mbani shënime për të gjitha çështjet, që ju interesojnë.

Dhe, tash unë do t'ua jap radhën të gjithë përfaqësuesve të institucioneve që janë këtu. Në fund, do ta keni kohën e juaj çdonjëri prej juve, që të merrni përgjigje për pyetjet që ju interesojnë. Tash, ju ftoj që të jemi të fokusuar në këtë pikë. Fillimisht, do t'ia jap fjalën Avokatit të Popullit dhe jo për diçka, por kisha kërkuar që të gjithë ju të prezantoheni për shkak të të gjithë këtyre që janë këtu dhe të pozitës institucionale që përfaqësoni. Domethënë, pas Avokatit të Popullit vazhdoni me radhë, çdonjëri të flasë për segmentet e caktuara, që agjencia ose puna ku është ai ndërlidhet direkt me çështje të caktuara, që ka të bëjë me zbatueshmërinë e këtij ligji. Nëse ishit pajtuar do të vazhdonim në këtë mënyrë, sepse mendoj se më lehtë do të kishim ardhur deri tek konkluzionet këtu. Urdhëroni, Avokat!

AVOKATI I POPULLIT: Faleminderit shumë, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të pranishëm,

Unë do të provoj të jem shumë i drejtpërdrejtë dhe shumë konkret. U fol shumë këtu për të arriturat dhe progresin që është bërë, unë e di që nuk është e diskutueshme absolutisht, mirëpo unë do të ndalem në disa çështje që janë pak më problematike, duke filluar prej problemit të barazisë gjinore, që u ngrit nga deputetja e nderuar.

Edhe dëgjova gjithashtu, që është çështje e trajtimit të strategjive dhe të politikave të Policisë, por nuk duhet harruar që ka tani pesë muaj, Kuvendi i Kosovës ka nxjerrë ligjin i cili njihet si Ligji për barazi gjinore e i cili ka vënë një normë 50/50 të përfaqësimit gjinor. Domethënë, kemi të bëjmë me një detyrim ligjor dhe jo me çështje strategjike e tjera, e tjera, por ka të bëjë me detyrimin për të pasur përfaqësim në të gjitha institucionet publike në normën 50/50. Bile, bile, të jem edhe më konkret, ky ligj për herë të parë ka vënë dhe ka futur një institucion juridik që njihet si institucioni i identitetit gjinor. Deri më tani kemi pasur barazinë gjinore, mirëpo tanimë është tejkaluar ky standard dhe është futur një standard i ri, që njihet si identitet gjinor, domethënë është obligim i të gjitha institucioneve publike, që pavarësisht normës 50/50 të përfaqësimit gjinor, të ketë kujdes edhe në punësimin e atyre njerëzve që kanë këtë identitet gjinor, mund të jenë meshkuj, ose mund të kenë ndjesi tjetër të orientimit ose “vice-versa”.

Domethënë, është një standard juridik ligjor që duhet pasur jashtëzakonisht kujdes edhe në hartimin e dokumenteve rregullative, sepse tanimë është çështje e përfunduar dhe çështje ligjore.

E dyta, që desha të përmend gjithashtu është shumë konkrete, ka të bëjë me bashkëpunimin e Policisë me institucionet tjera. Veç po jap një shembull konkret, ta zëmë në regjionin e Prizrenit bashkëpunimi me institucionet gjyqësore dhe Prokurorinë ka arritur, ose ka përfunduar me epilogun që i kemi mbi 13 mijë raste të vonesave të paekzekutuara, kanë të bëjnë kryesisht me vonesa gjyqësore, pjesa më e madhe e tyre kanë të bëjnë me çështje kundërvajtëse. Edhe tani, efekti i saj në praktikë. Nëse secili rast me një parametër ndoshta më të thjeshtë ndëshkimor, që do të mund të ishte 20 euro, një ndëshkim kundërvajtës, i shumëzohet me numrin prej 13 mijë njerëzve që i ikin përgjegjësisë, faktikisht detyrimeve ligjore që kanë dhe dispozita

ndëshkimore, krijon një kulturë jashtëzakonisht të lartë të përgjegjshmërisë qytetare ndaj sistemit gjyqësor.

Në Prishtinë, sa kam informata, është trefishi më i madh se sa në regjionin e Prizrenit dhe ka të bëjë kryesisht me mungesën e sistemit të adresave, për të cilat gjithashtu Policia ka problem. Në anën tjetër, vetë Policisë, besoj kolegët nga Policia do të dakordohen, kjo u sjell telashe dhe shpenzime të panevojshme, sepse përveç kuadrit profesional që angazhojnë në identifikimin e atyre njerëzve, ose gjetjen e atyre njerëzve, gjithashtu krijon edhe shpenzime të panevojshme materiale për Policinë, mos të flas për efektin tjetër shtesë, që ka të bëjë me mosinkasimin nga kasa shtetërore e ndëshkimeve që u janë vënë qytetarëve. Mirëpo, mbi të gjitha rrezikun më të madh, unë për vete si Avokat i Popullit, e shoh te krijimi i një kulture përgjegjshmërie. Nëse në Prizren e kemi 13 vetë, në Prishtinë është trefishi, mund ta merrni me mend sa është në nivelin e tërë Kosovës.

Institucioni i Avokatit të Popullit është duke kryer hetime për këtë çështje tani dhe shumë shpejt besoj, se do të dalim me vlerësimet tona. Mirëpo, është një çështje brengosëse që do të duhej të meritonte vëmendjen, jo vetëm të Policisë por të të gjitha autoriteteve tjera ndërlidhëse dhe kryesisht të agjencive të regjistrimit civilë, sepse kjo çështje duhet evituar sa më parë, ngase është nivel i lartë i ikjes nga përgjegjësia të qytetarëve të Kosovës dhe të kulturës së pandëshkueshmërisë.

Një çështje tjetër, që gjithashtu dëshiroj ta nënvizoj, ka të bëjë me përpunimin e statistikave. Këtu u përmend me plot të drejtë, edhe ne gjithashtu në praktikë kemi parë dhe kemi bashkëpunuar me Policinë në këtë drejtim gjithashtu duke u munduar të ndihmojmë me vërejtjet tona Policinë, që të jetë më efikase në këtë drejtim. Ka pasur shumë raste, kur në mungesë të përpunimit të statistikave, faktikisht janë shkaktuar shkelje më të rënda sistematike të të drejtave të njeriut. Ndoshta sa për ilustrim, e kemi përmendur edhe në takimin që kemi pasur me deputetë, kur kanë qenë në vizitë mu për këtë çështje, çështjen e ndeshjeve në trafik ose të aksidenteve në trafik, sidomos të fëmijëve nëpër shkolla, ku në një mungesë ndoshta të një analize më të mirë të këtyre rasteve, mund të evitohen këto situata për të ardhmen, që të mos përsëriten.

Ne kemi bërë një hulumtim të tillë dhe definitivisht na ka dalë ky rezultat dhe gjithashtu është reflektuar edhe në situata të tjera të ngjashme, u përmend për shembull, sistemi i gradimit të Policisë. Para se ndoshta të aludohet në nxjerrjen e një ligji të tillë, puna e parë që do të duhet të bëhet ishte të bëhet një vlerësim brenda strukturave të Policisë. Përpos asaj është efekti i nxjerrjes së një ligji për pensionim të parakohshëm, në mënyrë që të ketë një lloj paralogarie për pasjen e nevojës të gradimit në Polici që të jenë të harmonizuara dhe të kemi pastaj një dokument të gatshëm, i cili do të mund të zbatohet në praktikë e jo të shkojmë në anën e kundërt, të nxjerrim një ligj e pastaj të shohim sa janë nevojat e gradimit. Mendoj që do të ndihmonte definitivisht policinë.

Edhe në anën, ndoshta krejt e fundit, Institucioni i Avokati të Popullit – unë kam marr mandatin para pesë muajve dhe puna e parë që kam bërë ka qenë që të krijoj ura bashkëpunimi me institucionet, kuptohet gjithmonë, sepse Institucioni i Avokatit të Popullit bashkë me institucionet publike, qëllimi përfundimtar e ka mbrojtjen e interesit qytetar dhe të drejtat e tyre. Kështu që, kemi pasur një takim të suksesshëm me drejtorin e përgjithshëm të Policisë dhe qëllimi kryesor ka qenë që të vihen në lëvizje zbatimi i rekomandimit të Avokatit të Popullit dhe qasja e pakufizuar e Institucionit të Avokatit të Popullit, sepse përndryshe nuk mund të implementohet mandati dhe gjithashtu është një risi e re, që sjell Ligji për Avokatin e Popullit, sepse është krijuar mekanizmi për mbrojtje kundër torturës, që është një risi në Kosovë, është për herë të parë ky mekanizëm dhe është në kompetencën e Avokatit të Popullit. Detyra e këtij mekanizmi është të bëjë inspektime të rregullta në të gjitha qendrat dhe vendet, ku njerëzit mbahen të privuar prej lirisë, duke përfshirë kryesisht stacionet policore, ta zëmë, në rend të parë, me të cilat Avokati i Popullit do të synojë që të evitojë të gjitha shkeljet që mund të ndodhin në këtë kuadër.

Dhe, ndoshta krejt e fundit, një shqetësim kryesor që kemi pasur, ka të bëjë me pavarësinë e inspektoratit policor, i cili do të duhej të hetonte pretendimet për tejkalimin e autorizimeve nga ana e Policisë.

Nuk ka shumë vërejtje rreth punës, mirëpo shqetësimet kryesore të qytetarëve kanë pasur të bëjnë me joobjektivitetin, ose paanshmërinë e këtij mekanizmi dhe mendoj që është një shqetësim, sepse përderisa është në kuadër të të njëjtës strukturë, është vështirë që realisht të krijohet perceptimi objektiv te qytetari, se kjo strukturë është e paanshme në gjykimet e veta dhe vendimet e nxjerra në disa prej rasteve, pastaj që janë proceduar në gjykata, po ashtu kanë

vërtetuar një lloj, ta quaj, perceptimi të tillë të qytetarëve. Por, mendoj që ishte dashur të mendohet, që kjo strukturë bile së paku Inspektorati të pavarësohet sa më tepër që është e mundur, si në aspektin buxhetor, ashtu edhe në aspektin e emërimit dhe zgjedhjes së kuadrit, në kuadër të kësaj strukture.

Këto janë disa prioritete që ka Institucioni i Avokatit të Popullit. Faleminderit për vëmendjen.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë kërkoj që përgjigjet të jepen në fund nga të gjitha shqetësimet që dalin nga të gjithë këtu. Fjalën e ka Taibe Canolli.

TAIBE CANOLLI-Faleminderit!

Përsëritet për të gjithë! Unë mund ta plotësoj atë për të cilën u fol në mënyrë të përgjithësuar foli për të gjitha çështjet. Ndoshta më tepër do të fokusohesha te perspektiva gjinore, sepse udhëheq edhe shoqatën e cila merret me fuqizimin e rolit dhe të pozitës së femrës në kuadër të Policisë së Kosovës, i cili është si mekanizëm shtesë, që ndihmon në ngritjen e profilin apo imazhit të Policisë nga perspektiva gjinore. Këtu u diskutua shumë mirë dhe u cek fakti, se në aspektin ligjor çështja e perspektivës gjinore është shumë mirë e rregulluar dhe të gjitha aktet duke përfshirë ligjin dhe aktet tjera nënligjore, udhëzimet administrative ... shumë mirë e rregullojnë dhe në njëfarë forme e garantojnë gjithëpërfshirjen, barazinë dhe jodiskriminimin. Do të thotë, nuk ekziston asnjë problem

Problemi na paraqitet ndoshta në praktikë, ku mund të reflektohet me një numër ndoshta pak më të vogël të femrave, që e pamë se ka edhe rënie, e cila mund të vijë, mund të them lirisht, si pasojë e specifikave të profesionit, sepse dihet se profesioni i policor është profesion shumë i vështirë për ta ushtruar, jo vetëm për gjininë femërore, por në fakt edhe për gjininë mashkullore.

Ndërsa, problemi numër dy, të cilin ne kemi arritur ta identifikojmë është edhe numri i vogël i femrave të interesuar për aplikim. Ne në procesin e fundit kemi pasur diku mbi 19 mijë aplikacione në konkursin e fundit të hapur për zyrtarë policor, ku 10% prej tyre kanë qenë femra dhe këtu paraqitet ajo jobarazia. Kur t'u nënshtrohen proceseve të testimit, atëherë numri i femrave në raport me meshkuj është shumë më i vogël. Meqenëse, ne si institucion jemi të interesuar që të kemi kualitete të të punësuarve në Polici e jo kuantitete dhe procedurat e punësimit përjashtimisht të testit fizik janë të njëjta, domethënë për dy gjinitë. E potencoi edhe kolonel Riza, që në strategjinë e ardhshme ne kemi vendosur atje një objektiv, që kryesisht lidhet me perspektivën gjinore dhe me angazhimin e Policisë për të rritur numrin e zyrtareve policore në kuadër të Policisë.

Meqenëse, ne synojmë që përfshirjen etnike dhe gjinore të popullatës ta kemi në Polici të Kosovës, ne nuk jemi adhurues të kuotimit dhe po bëjmë përpjekje tash bashkërisht edhe me shoqatën edhe me njësinë për rekrutim dhe seleksionim, që në të ardhmen të fokusohemi në ato zona ku kemi një numër më të vogël të femrave, ta bëjmë sensibilizimin, vetëdijesimin dhe inkurajimin e tyre përmes projekteve të ndryshme, që në të ardhmen femra të jetë më e interesuar që të punojë në këtë profesion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash vazhdoni me radhë.

ARBEN VRAJOLLI: Unë jam Arben Vrajolli, drejtor i Departamentit të Inspektimeve, përfaqësoj Inspektoratin Policor të Kosovës.

Fillimisht dua të shfrytëzoj këtë takim që t'ju falënderoj dhe do të mundohem që në bazë të autorizimit të Inspektoratit Policor të Kosovës pyetjeve parlamentare, që ju të nderuar deputetë, keni dërguar, t'u jap... ta bëj një prezantim të shkurtër lidhur me punën e Inspektoratit Policor.

Siç e dini, Inspektorati Policor ka dy instrumente me anë të të cilave mbikëqyr Policinë e Kosovës si një mekanizëm i jashtëm prej Policisë së Kosovës, siç janë inspektimet dhe hetimet.

Fillimisht, do t'i prezantoj disa statistika që janë të vitit 2014, se cilat veprime ka marrë Inspektorati Policor i Kosovës bazuar në këto kompetenca, për të siguruar se Policia e Kosovës i kryen detyrat e veta sipas ligjit dhe rregulloreve që janë në fuqi. Siç e dini, Inspektorati Policor i Kosovës pranon ankesa dhe pranon të gjitha ankesat e qytetarëve që kanë të bëjnë me punën e Policisë së Kosovës dhe, gjatë vitit 2014 Inspektorati Policor ka pranuar 1304 ankesa dhe prej 1300 ankesave të pranuar nga qytetarët e Kosovës kanë qenë 608 ankesa që janë proceduar në Departamentin e Hetimeve të IPK-së për hetime preliminare, nga ato 674 ankesa janë dërguar në Drejtorinë e Hetimeve të Brendshme në Policinë e Kosovës për hetim disiplinor.

608 ankesa kanë qenë me elemente të veprës penale, të cilat janë dyshuar për vepër penale, ndërsa 674 ankesa nuk i kanë pasur elementet e veprës penale dhe ato janë proceduar në Policinë e Kosovës për hetime disiplinore. 9 ankesa janë proceduar në Departamentin e hetimeve speciale për grumbullim të informatave, një ankesë është dërguar në trajtim në Departamentin e inspektimeve, 8 ankesa janë mbyllur në IPK dhe 4 ankesa janë dërguar në Komisionin e Ankesave dhe Parashtresave në kuadër të PK-së.

Duhet të themi, se edhe gjatë vitit 2004 janë parashtruar 133 kallëzime penale, 87 kanë shkuar me raport të veçantë në Prokurori, ndërsa vetëm 5 kallëzime penale janë hedhur poshtë nga prokurori për mungesë të fakteve. Sa i përket inspektimeve vitin e kaluar Inspektorati Policor i Kosovës ka realizuar 7 inspektime, prej të cilave kanë dalë edhe 148 rekomandime.

Ajo që dua të them këtu, është se ato të cilat u përmendën këtu, shumica prej vërejtjeve tuaja si Komision Parlament, tashmë janë cekur në shumë raporte të inspektimit. Raportet e inspektimit, siç e dini, bëhen publike edhe për qytetarët e Kosovës, të cilat janë të paraqitura në ueb-faqen zyrtare të Inspektoratit Policor të Kosovës.

Këto rekomandime, dua ta ceki se kemi një bashkëpunim shumë të mirë me Policinë e Kosovës. Çdo raport i inspektimit është një metodologji e punës, të cilën ne e zbatojmë, që çdoherë mbajmë takime përmbyllëse me Policinë e Kosovës, ku ne paraqesim argumentet tona dhe të gjeturat tona dhe në bazë të atyre pastaj publikojmë edhe për qytetarët.

Kemi realizuar edhe një inspektim, sa i përket implementimit të këtyre rekomandimeve në nivelin e implementimit të këtyre rekomandimeve, ku kemi vërejtur se ka një qasje shumë pozitive në realizimin e këtyre rekomandimeve, duke marrë gjithmonë parasysh se Policia e

Kosovës është një organizatë dinamike dhe shpeshherë implementimi i këtyre rekomandimeve merr kohë, duke pasur parasysh edhe çështjet buxhetore edhe aspektet tjera.

U ngrit këtu çështja e testit të integritetit, këtu me ne është edhe drejtoresha e Departamentit për hetime speciale dhe ndoshta do t'ia kaloja fjalën drejtoreshës.

ALBANA OSMANI: Përshëndetje të gjithëve!

Unë jam Albana Osmani. Jam drejtoreshë e Departamentit për hetime speciale në Inspektoratin Policor të Kosovës.

Në kuadër të departamentit që unë menaxhoj kemi Divizionin për hetime proaktive dhe testin e integritetit. Më lejoni t'ju informoj se ky divizion merret me rastet e organizimit të testeve të integritetit, ku për informimin e juaj, zoti kryesues, ju tashmë e potencuat që në njoftimet që i kemi bërë apo raportimet në raportet vjetore të punës nuk kemi cekur apo nuk kemi përmendur statistika lidhur me rastin e testeve të integritetit.

Për informimin e juaj ne veçse e kemi bërë njoftimet por nuk jemi thirrur në vepra penale të hetimit të integritetit. Kjo ka ardhur si pasojë e asaj se kodi i procedurës penale të Kosovës nuk e parasheh veprën penale të hetimit të integritetit, por parasheh veprat tjera penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, ku hyjnë veprat penale të ekonomisë, kur është marrja e ryshfeti dhe keqpërdorimi i detyrës zyrtare.

Lidhur me këtë ne kemi realizuar disa teste të integritetit dhe fatmirësisht kemi pasur raste, kur zyrtarët apo punonjësit policorë kanë kaluar me sukses testin e integritetit dhe kjo është një e mirë, qoftë për Policinë e Kosovës, qoftë edhe për ne por, te çështja e hetimit të integritetit rastet e testeve që i kemi zhvilluar, ku një zyrtar ka rënë prej testit të integritetit, atëherë ka lindur nevoja, ashtu siç e parasheh edhe Udhëzimi Administrativ për hetim të integritetit, të kërkojmë një autorizim prej prokurorit, të fillojmë t'i përdorim teknikat dhe metodat e veçanta hetimore, ku në këto raste prokurori ka lëshuar urdhëresë për zbatimin e masave të fshehta hetimore, siç janë masat e vëzhgimit dhe përgjimit dhe prej këtyre masave ka rezultuar në raste të caktuara të veprave penale të marrjes së ryshfeti dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare, të cilat vepra penale veçse i kemi potencuar në raportet vjetore të punës prej marrjes së kompetencave prej vitit 2011 e tani.

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdoni ju.

BLERIM OLLURI: Përshëndetje për të gjithë!

Unë jam Blerim Olluri, kryeshef ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë.

Fillimisht më lejoni të ju falënderoj për ftesën që të marr pjesë dhe të dëgjoj diskutimet e juaja, deputetë të nderuar, dhe kolegëve tanë nga Policia e Kosovës, Inspektorati dhe përfaqësuesve tjerë të institucioneve.

Nuk do ta zgjas. Sa i përket bashkëpunimit me Policinë e Kosovës Agjencia e Kosovës për Forenzikë bazohet në Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë dhe udhëzimet administrative, që burojnë nga ky ligj. Ka një bashkëpunim shumë të mirë me Policinë e

Kosovës dhe ofron informacione, qoftë përmes ekspertizës Forenzike apo përmes të dhënave informative që ka në baza të dhënave nacionale kriminale, në baza ditore dhe sa i përket bashkëpunimit, domethënë jemi shumë në rregull.

Informacionin që ofrojmë është krejtësisht i bazuar në standarde ndërkombëtare, sepse kemi arritur të standardizojmë 80% të metodave që posedon Agjencia e Kosovës për Forenzikë, për ekspertizë forenzike. Një çështje që dëshiroj ta ngre në këtë nivel që është ndoshta për diskutim dhe si çështje që duhet në të ardhmen të mendohet dhe të kemi ndoshta një legjislacion apo një normë juridike, që rregullon çështjen e të dhënave që posedon Agjencia e Kosovës për Forenzikë, është që ndoshta në të ardhmen duhet të vendosen edhe policë zyrtarë në kuadër të të dhënave që posedojmë, siç është sistemi AFIS, KODIS dhe AIBIS, por ndoshta edhe zyrtarë të Inspektoratit Policor të Kosovës, që merren me hetime të drejtpërdrejta. Është fjala për sistemin për gjurmë të gishtave, sistemi AFIS, që nëse i referohemi Rajonit, shumica e shteteve i kanë të vendosura zyrtarët policorë në kuadër të këtyre sistemeve. Pastaj, është sistemi KODIS, sistemi për të dhënat apo profilet e ADN-së, si dhe sistemi AIBIS apo sistemi për identifikim balistik apo më konkretisht, regjistri i të dhënave të armëve zyrtare, që do të vendosen në kuadër të këtij sistemi të Policisë së Kosovës apo ndoshta edhe të inspektoratit.

Krejt kjo, që të ndihmojë në eliminimin e zyrtarëve policorë të cilët marrin pjesë në vendin e ngjarjes apo kanë të bëjnë me vendin e ngjarjes, por që mund të ndikojë dhe në parandalimin dhe identifikimin e zyrtarëve policorë të cilët mund të jenë të inkriminuar apo të marrin pjesë në ndonjë aktivitet kriminal, si dhe zbulimin apo identifikimin e tyre.

Ne në këtë kuptim këtë vit do të shqyrtojmë mundësinë që të nisim të marrim një iniciativë apo një nismë ligjore, e cila do të bëjë administrimin e të dhënave forenzike apo ligji që ka bëjë me nismën ligjore që ka të bëjë me administrimin e të dhënave forenzike në kuadër të vendit, ku do të parashiheshin të gjitha këto procese apo koncepte, këto procedura që kanë të bëjnë me të dhënat kriminale në kuadër të këtyre sistemeve, duke përfshirë edhe një regjister të veçantë për zyrtarë policorë, në kuadër të sistemit AFIS, KODIS dhe sistemit AIBIS, domethënë sistemi për gjurmë ti gishtave, sistemi për profil të ADN-së dhe sistemi për regjistrin e të dhënave zyrtare të gëzhgës dhe të predhës nga arma zyrtare në kuadër të Policisë së Kosovës.

Andaj, shfrytëzoj rastin që edhe nga ju si kryesues i Komisionit për Mbikëqyrje të Zbatimit të Ligjit të Policisë, por edhe deputetë të nderuar, që të na përkrahni në këtë nismë, sepse vlerësojmë se është një nismë e rëndësishme që në kuadër të legjislacionit vendor të jetë edhe një ligj i tillë, i cili rregullon këtë çështje shumë të rëndësishme, sepse është tejet e rëndësishme në njërën anë ka të bëjë edhe me të drejtat e njeriut, me qëndrimin e të dhënave në kuadër të sistemeve, domethënë me të drejta të personave të cilët mund të jenë të inkriminuar apo të dyshimtë për kryerje të veprës penale, por që njëkohësisht kjo ndërlidhet edhe me procedurën penale, në të cilën ne vlerësojmë që gjatë vitit të ardhshëm të bëjmë një qasje në kuadër të... kemi informacion se procedura penale do të amendamentohet apo ndryshohet dhe plotësohet vitin e ardhshëm, sponsorizuar nga Ministria e Drejtësisë. Ne do të mundohemi që të përfaqësojmë me një anëtar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, në mënyrë që të jetë i vendosur edhe ky element në kuadër të procedurës penale.

Krejt kjo, nëse i referohemi edhe Rajonit edhe Policia e Shqipërisë i ka të vendosur në kuadër të sistemeve policët zyrtarë, krejt me qëllim të eliminimit, domethënë në rast të lënies së gjurmëve në vend të ngjarjes, sepse po paraqet mjaft vështirësi për neve, në mënyrë që t'i eliminojmë në mënyrë individuale pastaj, qoftë me armën e cila sillet tek ne me gjurmë papilare apo edhe me profilin e ADN-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Para se të vazhdoni, natyrisht se ne do ta përkrahim si komision këtë kërkesën e juaj. Ne na nevojiten vetëm informacione sa më të shumta, që të përkrahët një nismë ligjore, sepse në fund të fundit kjo edhe është puna jonë. Urdhëroni!

MËRGIM HIMAJ: Faleminderit!

Unë jam Mërgim Himaj. Jam udhëheqës i Divizionit për hartim dhe harmonizim të legjislacionit, Departamentit Ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Së pari, ju falënderoj për këtë nismë, këtë punë të mirë që jeni duke e bërë. Po ashtu, falënderoj edhe zotin kolonel Riza Shillova për prezantimin.

Meqenëse, vij nga Departamenti ligjor i Ministrisë së Punëve të Brendshme do të cekja vetëm tri pika që kanë të bëjnë me legjislacionin. Pika e parë sa i përket legjislacionit dytësor apo sekondar për zbatimin e Ligjit për Policinë, janë të hartuara të gjitha aktet nënligjore, konform Ligjit për Policinë.

Pika e dytë është për pensionimin e zyrtarëve Policor. Ashtu siç e ceku edhe kolonel Riza, Projektligji për pensionimin e zyrtarëve policor është finalizuar nga grupi punues, i ka kryer të gjitha procedurat e hartimit konform legjislacionit për hartimin e legjislacionit, por ka ngecur vetëm te kostoja financiare. Për shkak të kostos së lartë financiare nuk ka mundur të procedohet më tutje. Ky është viti i tretë që është duke u prolonguar dhe nuk është duke u proceduar në Qeveri për miratim, për shkak të kostos së lartë financiare.

Po ashtu, desha edhe një informim të Ligji për infrastrukturë kritike. Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me zyrën ligjore të kryeministrit dhe agjencitë tjera përkatëse, ka marrë iniciativën për hartimin e një ligji për rregullimin e kësaj fushe, infrastrukturës kritike, që ende nuk është e rregulluar në Kosovë. Ne kemi bërë propozimin vitin e kaluar për përfshirjen në listën e koncept-dokumenteve të Qeverisë dhe koncept-dokumentin për infrastrukturën kritike, i cili është dokument i paraprin hartimit të Ligjit me legjislacionin për hartimin e legjislacionit është e paraparë që çdo ligj që parashihet të ndryshohet apo të hartohet duhet të hartohet njëherë një koncept-dokument, ku duhet të paraqiten arsyet e hartimit apo ndryshim-plotësimit të ndonjë ligji.

Koncept-dokumenti është hartuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i ka kryer konsultimet paraprake konform Rregullores së punës së Qeverisë, nenit 7. Tash jemi në fazën e shqyrtimit të komenteve të pranuar nga gjatë fazës së konsultimit paraprak. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëro Arbër.

ARBËR BEKA: Përshëndetje për të gjithë! Quhem Arbër Beka, e udhëheq Divizionin e Inspektoratit Policor të Kosovës.

Falënderoj për bashkëpunimin e ndërsjellë, sidomos Komisionin parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri që kemi pasur bashkëpunim të vazhdueshëm, qoftë përmes pyetjeve e përgjigjeve gjatë procesit të mbikëqyrjes për zbatimin e Ligjit për Policinë e Kosovës.

